

VENDIM
Nr. 758, datë 9.12.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 253, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KONSOLIDIMIT
FINANCIAR TË SEKTORIT PUBLIK, ELEKTROENERGJETIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “E”, të seksionit IV, e të pikës 22, të shtojcës, që i bashkëlidhet marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, ratifikuar me ligjin nr. 170/2014, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të dhënat e tabelës 6 “Reduktimi i humbjeve të rishikuara dhe synimet për grumbullimin e të ardhurave/arkëtimeve”, të kreut IV, të tekstit të planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjetik, që i bashkëlidhet vendimit nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me të dhënat në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., OSHEE Group sh.a, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a dhe Enti Rregullator i Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

	Humbjet totale (%)	Mbledhja e të ardhurave (%)
2014	37.8	91.9
2015	31.3	98.3
2016	28.0	92.0
2017	26.4	97.0
2018	23.9	95.0
2019	21.8	95.0
2020	21.5	95.0
2021	20.5	95.0
2022	19.6	95.0
2023	19.0	
2024	18.5	
2025	18.1	
2026	17.8	